



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER HELENA B. SHËNGJERGJI
(VAKO)
ADRESA NR.10, BLV"GJERGJ
FISHTA", NR.6, NR.8, NR.3
TEL: 682080755

VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 172

Nr. koleksioni: 27

Tirane më 08/02/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021052860003218195



LËSHIMI I DËSHMISË SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Sot në datën 08/02/2021 (dymijë e njëzetënjë) unë Helena Shëngjergji (Vako) noter i Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë më zyrë në Blvd "Gjergj Fishta" Nd. 6, H.3, ap. 8, mora në shqyrtim kërkesën dhe dokumentacionin e

KËRKUES:

Dario Kapaj, mashkull, i biri i Gezim dhe Rudina, i datelindjes 19/06/1997, lindur ne Athine Greqi, banues ne Tiranë, Rr. "Andon Zako Çajupi, nd. 20, H. 4, Ap 11, Njesia Administrative Nr. 5, Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019 Tirane, me gjendje civile beqar, shtetas shqiptar, me numer personal identiteti J70619059G, (i biri i trashëgimlënësit)

OBJEKTI I KËRKESËS: Ndryshimi i Vendimit për Lëshimin e Dëshmisë se Trashëgimisë Nr. Rep 1553 Nr. Kol. 302 dt 21/12/2020 noter Helena Shengjergji (Vako), pas regjistrimit të heqjes dorë nga trashëgimia, dhe Lëshimi e nje dëshmie te re të trashëgimisë ligjore për sistemimin e të drejtave dhe detyrimeve të të ndjerit z. GEZIM KAPAJ, i cili ka ndërruar jetë më 27/11/2020, me vendbanim te fundit në Tiranë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 316, 317, 318, 333, 334, 335, 337, 336, 338, 339 348, 360, 361 e vijues i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë", me ndryshimet, neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 99, 111, 112, 113, 115, 117 e vijues të ligjit Nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë


Kërkuesi z. Dario Kapaj ka kërkuar lëshimin e një dëshmie të re të trashëgimisë të të ndjerit Gezim Kapaj. Së pari unë noter i kontrollova kompetencën lëndore dhe kompetencën vendore.

Duke parë natyrën e kërkesës vërej se ekziston kompetenca lëndore dhe si e tillë kjo kërkesë mund të trajtohet prej meje noterit. Kështu, neni 348 i K.Civil parashikon se: "Cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese në trashëgimi caktohen në dëshminë e trashëgimisë, të lëshuar nga noterit, pas paraqitjes së certifikatës së vdekjes së trashëgimlënësit, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod dhe në ligjin për noterinë." Neni 112 i ligjit 110/2018 "Për Noterinë", parashikon se:

"Dëshmia e trashëgimisë lëshohet nga noterit, në përputhje me rregullat e caktuara në Kodin Civil, si dhe në këtë ligj."

Përsa i përket kompetencës vendore, duke qënë se vendbanimi i fundit i të ndjerit, bazuar në Certifikatën e Vdekjes ka qënë në Tiranë, atëherë bazuar në paragrafin e dytë të nenit 348 të K.Civil, i cili parashikon se: "Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet nga noterit i njësisë vendore ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi.", unë si noter i njësisë vendore Tiranë kam kompetencë vendore.

Përsa i përket legjitimitetit të kërkuesit, duke qënë se siç provohet nga Çertifikata Familjare është në lidhje gjinie të afërt me të ndjerin, më konkretisht djali i tij, në bazë të nenit 360 të Kodit Civil i cili parashikon se; "Trashëgimtarët ligjorë janë fëmijët, fëmijët e fëmijve, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur, gjyshja e gjyshja e të paralindurit e tjerë, personat e paafte për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, të afërmit e tjerë



A202105256000215135

deri në shkallën e gjashtë, si dhe shteti. Këta thirren në trashëgim sipas rradhës të caktuar në këtë Kod.”, ai hyn në rradhën e trashëgimtarëve ligjorë të rradhës së parë të të ndjerit dhe për rrjedhojë ka interes të ligjshëm në kërkimin e lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë.

Duke qënë se:

- pas verifikimit nëse i ndjeri ka lënë testament, nga përgjigja e DHKN, administruar në dosje, me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës 1344-6, rezulton se e ndjeri nuk ka lënë testament,
- duke qene se jemi përpara rastit kur është lëshuar Dëshmia e Trashëgimisë Akti noterial Nr Rep. 1553 Nr Kol. 302 dt 21/12/2020 noter Helena Shëngjergji (Vako)
- duke qenë se trashëgimtarja ligjore Rudina Kapaj me aktin noterial Deklaratë Noteriale Nr. Rep. 141 Nr. Kol. 22 datë 01/02/2021 noter Helena Shëngjergji (Vako) ka hequr dorë nga trashëgimia e Gëzim Kapaj brenda afatit 3 mujor të çeljes së saj
- duke qenë se trashëgimtarja ligjore Geri Kapaj me aktin Noterial Deklaratë Noteriale Nr Rep. 142 Nr. kol 23 dt 01/02/2021 ka hequr dore nga Trashëgimia e Gezim Kapaj brenda afatit 3 mujor të çeljes së saj,
- bazuar në kompetencat e dhëna në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë neni 333 e vijues si dhe Nenin 115, 117 të ligjit 110/2018 “Për Noterinë” unë noteri procedoj me lëshimin e dëshmisë së re të trashëgimisë të z. Gezim Kapaj, ku do te pasqyroj ndryshimin në rrethin e trashëgimtarëve, pjesët takuese si dhe te dhënat mbi aktin e heqjes dorë nga trashëgimia

Përsa i përket themelit të kërkesës, pasi shqyrtova dokumentacionin e dosjes, shpjegimet e kërkuarit, Çertifikatën e vdekjes, Çertifikatat e martesës, Çertifikatën familjare, Çertifikatën personale të trashëgimtarëve, Deklaratat Noteriale per heqje dore nga Trashegimia

VËREJ SE:

Nga kërkuari, është kërkuar “Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore” për trashëgimlënësin të ndjerin **GEZIM KAPAJ**, mashkull, i biri i Tetem dhe Fatime, i datelindjes 22/05/1959 lindur ne Hekal Fier, shtetas shqiptar, me numer personal identiteti F90522047Q, me gjendje civile i martuar, i cili ka ndërruar jetë më 27/11/2020, me vendbanim te fundit në Tiranë. Ky fakt provohet nga Çertifikatë Vdekje, lëshuar ne baze te aktit te vdekjes dt 07/12/2020, nga Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Tirane Nr. 5 377, Zyra e Gjendjes Civile 377 Njesia Administrative Nr. 5.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur të administruar në dosje dhe shpjegimet e kërkuarit rezulton se; Sipas Çertifikates se Martesës, (nga Akti i martesës viti 1998) lëshuar në datën 10/12/2020 nga Qarku Tiranë, Rrethi Tirane, Zyra e Gjendjes Civile (Arkiva) Bashkia Tirane, i ndjeri Gezim Kapaj, ka lidhur martese me Rudina Halitaj, e bija e Faruk dhe Fatbardha, e datelindjes 14/01/1972, mbiemri pas martese Kapaj.

Sipas Çertifikatës së Përberjes Familjare, dt 09/12/2020 lëshuar nga Bashkia Tiranë Njesia Administrative Nr. 5 377, Zyra e Gjendjes Civile 377, në bazë të regjistrit kombetar te gjendjes civile te vitit 2010, rezulton se në përbërjen familjare të familjes të z. Gezim Kapaj, te cilet vijne ne trashegimi janë:

- Rudina Kapaj, femër e bija e Faruk dhe Fatbardha, e datëlindjes 14/01/1972 (e shoqja)
- Dario Kapaj, mashkull, i biri i Gezim dhe Rudina, i datëlindjes 19/06/1997 (i biri)
- Geri Kapaj, femër, e bija e Gezim dhe Rudina, e datëlindjes 07/05/1999 (e bija)



A2021052360033215153

Kërkuesi me vullnetin e tij të lirë dhe i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimit të remë deklaroi se; në cilësinë e trashëgimtarit ligjor nuk ka ndonjë pengesë ligjore për të trashëguar; nuk ka trashëgimtarë të tjerë ligjorë të radhës së parë brenda apo jashtë martese apo fëmijë të tjerë të birësuar, nuk ka ndonjë akt i cili të ketë shpallur padenjësinë për ta trashëguar. trashëgimtarët Zj Rudina Kapaj dhe zj. Geri Kapaj kane hequr dorë nga trashëgimia

Sa më sipër shpjegohen nga dokumentacioni i paraqitur bashkëngjitur këtij akti.

Pasi u renditën faktet e mësipërme, në bazë të neneve 318, 318/1 dhe 318/2 të Kodit Civil të ndryshuar, në rastin konkret koha kur çelet trashëgimia është data e vdekjes së trashëgimlënësit z. Gezim Kapaj, dhe pikërisht data 27/11/2020, vendi i çeljes së trashëgimisë është në Tiranë, vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit. Ligji që do të aplikohet për çeljen e trashëgimisë është Kodi Civil në fuqi në datën 27/11/2020

Në bazë të nenit 317 të Kodit Civil të sipërpërmendur trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament. Në rastin konkret rezultoi se nuk është lënë testament. Duke qënë se nuk rezultoi të jetë lënë testament, për të lëshuar dëshminë e trashëgimisë, do të zbatohen dispozitat ligjore të Kodit Civil që rregullojnë trashëgiminë ligjore.

Në bazë të Kodit Civil në fuqi në datën 27/11/2020 që një person të mund të jetë trashëgimtar ligjor do duhet të plotësojë në mënyrë kumulative një sërë kushtesh si:

- -së pari të ketë zotësi për të trashëguar;
- -së dyti të bëjë pjesë në rradhën e trashëgimtarëve ligjorë;
- -së treti të mos jetë shpallur i padenjë për të trashëguar, ose të mos jetë përjashtuar nga trashëgimi, ose të mos ketë hequr dorë nga trashëgimi sic përcaktohen nga ligji.

Përsa i përket kushtit të parë, zotësi për të trashëguar në bazë të nenit 320 të K.C, *“Ka personi që në kohën e çeljes së trashëgimisë, është gjallë,.....”*

Përsa i përket kushtit të dytë, neni 360 i K.C parashikon se: *“Trashëgimtarë ligjorë janë fëmijët, fëmijët e fëmijëve bashkëshorti, prindërit Këta thirren në trashëgimi sipas radhës së përcaktuar në këtë Kod.”*

Përsa i përket kushtit të tretë, neni 361/1/2 i Kodit Civil i cili parashikon se *“Në radhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë apo i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta. Kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, është bërë i padenjë për të trashëguar, ka hequr dorë nga trashëgimi, ose është i përjashtuar nga trashëgimi, në vend të tij hyjnë me zëvendësim fëmijët e tij dhe kur për shkaqet e sipërme nuk mund të jenë trashëgimtarë, vijnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kufizim. Në këtë rast, pjesa e prindit që nuk trashëgon, ndahet ndërmjet të paslindurve në pjesë të barabarta.”*

Nga interpretimi i dispozitave të mësipërme ligjore rezulton se kur çelet trashëgimia ligjore në radhë të parë përfitojnë bashkëshortja dhe fëmijët e trashëgimlënësit në pjesë të barabarta, të cilët janë gjallë në çastin e çeljes së trashëgimisë, nuk kanë hequr dorë nga trashëgimia apo të jenë shpallur të padenjë apo të jenë përjashtuar nga trashëgimia.

Nisur nga rrethanat e faktit siç rezultuan nga dokumentacioni i administruar në dosje dhe shpjegimet e kërkuesit në rastin konkret rezulton se; bashkëshortja e trashëgimlënësit Rudina Kapaj dhe dy fëmijet Dario Kapaj dhe Geri Kapaj kane qënë gjallë në datën e çeljes së trashëgimisë, bëjnë pjesë në radhën e trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë, nuk jane shpallur te padenjë për të trashëguar,



kanë zotësi juridike për ta trashëguar, duke trashëguar secili 1/3 pjesë të pasurisë trashëgimore të të ndjerit. Bazuar mbi keto fakte mbi bazën e kërkesës së kërkueses Rudina Kapaj u mor vendimi për lëshimin e Dëshmise se Trashëgimisë Nr. Rep. 1553, Nr Kol. 302 dt 21/12/2020 Noter Helena Shëngjergji (Vako) duke caktuar si trashëgimtarë ligjore Rudina Kapaj, Dario Kapaj dhe Geri Kapaj me 1/3 pjese ideale secili

Rezulton se trashëgimtarja Rudina Kapaj ka ushtruar të drejtën e heqjes dorë nga trashëgimia, brenda afatit 3 muajor nga data e çeljes së trashëgimisë si dhe konfirmohet nga Deklarata Noteriale Nr. Rep. 141 Nr. Kol. 22 dt 01/02/2021 e regjistruar nga unë noter Helena Shëngjergji (Vako), duke deklaruar se heq dorë nga e gjithë trashëgimia e lënë nga bashkëshorti i saj Gezim Kapaj, se nuk ka hequr apo fshehur sende nga trashëgimia, nuk është sjellë si trashëgimtare, nuk ka femije të mitur, nuk ka femije të lindur jashtë martesë dhe as persona të paaftë që vijnë në ngarkimin e saj në trashëgim me zëvendësim.

Rezulton se trashëgimtarja Geri Kapaj ka ushtruar të drejtën e heqjes dorë nga trashëgimia, brenda afatit 3 muajor nga data e çeljes së trashëgimisë si dhe konfirmohet nga Deklarata Noteriale Nr. Rep. 142 Nr. Kol. 23 dt 01/02/2021 e regjistruar nga unë noter Helena Shëngjergji (Vako), duke deklaruar se heq dorë nga e gjithë trashëgimia e lënë nga babai i saj Gezim Kapaj, se nuk ka hequr apo fshehur sende nga trashëgimia, nuk është sjellë si trashëgimtare, nuk ka femije të mitur, nuk ka femijë të lindur jashtë martesë dhe as persona të paaftë që vijnë në ngarkimin e saj në trashëgim me zëvendësim

Neni 333 i Kodit Civil paragrafi 1, përcakton se; “Heqja dorë nga trashëgimia duhet të bëhet me deklaratë të shkruar, që regjistrohet te noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimia, ose me deklaratë noteriale të redaktuar nga noteri.

Neni 334 i Kodit Civil përcakton se: “Ai që ka hequr dorë nga trashëgimi, quhet se nuk është thirrur ndonjëherë në trashëgim”.

Bazuar në nenin 370 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë “Kur një nga bashkëtrashëgimtarët që thirret në trashëgim ka vdekur para trashëgimlënësit, ose është bërë i padënjë, ose ka hequr dorë nga trashëgimi, ose është përjashtuar nga trashëgimi dhe nuk ka persona që trashëgojnë me zëvendësim, pjesa që i takon atij u shtohet pjesëve të bashkëtrashëgimtarëve të asaj radhe. Pra Me heqjen dorë nga trashëgimia të trashëgimtarit Rudina Kapaj dhe Geri Kapaj, pjesa e tyre takuese e trashëgimise u kalon trashëgimtarëve të tjerë që thirren në trashëgim.

Bazuar në Neni 335 të Kodit Civil në fuqi “Heqja dorë nga trashëgimi mund të bëhet brenda 3 muajve nga çelja e trashëgimisë dhe kur trashëgimtari është jashtë shtetit, jo më vonë se 6 muaj”.

Në rastin tonë rezulton se i ndjeri Gezim Kapaj ka ndërruar jetë me 27/11/2020 fakt i konfirmuar nga Certifikata e Vdekjes.

Zj. Rudina Kapaj ka hequr dorë nga trashëgimia në dt 01/02/2021. Në keto kushte jemi brenda afatit ligjor 3 (tre) muajor të heqjes dorë nga trashëgimia dhe

Zj. Geri Kapaj ka hequr dorë nga trashëgimia në dt 01/02/2021. Në keto kushte jemi brenda afatit ligjor 3 (tre) muajor të heqjes dorë nga trashëgimia.

Bazuar në paragrafin 3 të nenit 333 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, “Pas regjistrimit të heqjes dorë nga trashëgimia, noteri kryesisht lëshon një dëshmi të re trashëgimie, ku pasqyrohet



A2021052560033219195

ndryshimi në rrethin e trashëgimtarëve, si dhe pjesët e tyre takuese, të cilën ia dërgon personit që ka kërkuar lëshimin e dëshmisë fillestare të trashëgimisë”

Bazuar ne Neni 117 te ligjit 110/2018 “Per Noterine” Veprimet e noterit në rastin e heqjes dorë nga trashëgimia pika 1, 1. Me kërkesën e trashëgimtarit ligjor dhe/ose testamentar, si dhe me kërkesën e personit që kërkon të heqë dorë nga trashëgimia, noteri, në bazë të kërkesave të Kodit Civil, harton deklaratën noteriale-në emër të kërkuesit, për heqjen dorë nga trashëgimia.

3. Në rastin kur është lëshuar më pare dëshmia e trashëgimisë dhe trashëgimtari kërkon të heqë dorë brenda afatit ligjor, atëherë trashëgimtari harton deklaratën noteriale për heqjen dorë nga trashëgimia.

4. Pas hartimit të deklaratës noteriale për heqje dorë nga e drejta e trashëgimisë, noteri lëshon dëshminë e re të trashëgimisë, sipas parashikimeve të Kodit Civil, ku pasqyron ndryshimet në rrethin e trashëgimtarëve, pjesët e tyre takuese, si dhe të dhënat mbi aktin e heqjes dorë nga trashëgimia

Si dhe ne piken 1 dhe 2 te nenit 115 te Ligjit 110/2018 “per Noterine” “Ndryshimi i dëshmisë së trashëgimisë 1. Noteri, pasi regjistron heqjen dorë nga trashëgimia, kur është lëshuar më parë një dëshmi, procedon me lëshimin e një dëshmie të re trashëgimie, të cilën ua njofton menjëherë të gjithë personave, të cilëve, sipas nenit 113, të këtij ligji, u është lëshuar një kopje origjinale e dëshmisë fillestare të trashëgimisë. 2. Në dëshminë e re të trashëgimisë, noteri pasqyron të dhënat mbi aktin e heqjes dorë nga trashëgimia, ndryshimet në rrethin e trashëgimtarëve, si dhe pjesët e tyre takuese.

Une noteri procedoj me lëshimin e një dëshmie të re trashëgimie për të ndjerin Gezim Kapaj, ku do të pasqyroj ndryshimin në rrethin e trashëgimtarëve ligjore te tij, si dhe pjesët e tyre takuese.

Ndodhur ne keto kushte trashëgimtar ligjor i radhës së parë i të ndjerit Gezim Kapaj i cili vjen ne trashëgimi është Dario Kapaj, i biri, i cili trashëgon të gjithë pasurine e luajtshme dhe të paluajtshme të trashëgimlënësit

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 316, 317, 318, 318/1, 318/2, 320, 330, 333, 334, 335, 348, 360, 361, 370, të Kodit Civil, të ndryshuar me ligjin Nr. 121/2013, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligin 7850 dt 29.07.1997 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” Neni 388 i Kodit të Procedurës Civile; Ligjit 110/2018 “Për Noterinë”

VENDOSA:

1. Pranimin e kërkesës se kërkuesit
2. Ndryshimin e dëshmisë së trashëgimisë Nr. Rep. 1553 Nr. Kol. 302 dt 21/12/2020 noter Helena Shëngjergji (Vako), pas regjistrimit të heqjes dorë nga trashëgimia
3. Lëshimin e një dëshmie te re të trashëgimise ligjore për të ndjerin z. **GEZIM KAPAJ**, mashkull, i biri i Tetem dhe Fatime, i datëlindjes 22/05/1959, lindur ne Hekal Fier, shtetas shqiptar, me gjendje civile “i martuar”, me numer personal identiteti F90522047Q, me vendbanim te fundit ne Tirane, e cila çelet në datën e vdekjes me 27/11/2020.
4. Njohjen si trashegimtar të vetëm ligjor të radhës së parë të trashëgimlënësit;



- **Dario Kapaj**, mashkull, i biri i **Gëzim dhe Rudina**, i datelindjes 19/06/1997, lindur ne Athine Greqi, me gjendje civile beqar, shtetas shqiptar, me numer personal identiteti J70619059G, (i biri i trashëgimlënësit)-i cili trashëgon të gjithë pasurinë trashëgimore të Gezim Kapaj (te luajtshme dhe te paluajtshme) dhe te drejtat mbi to

5. Në këto raporte kalojnë dhe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo trashëgimi.
6. Dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme nuk mund të çënojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës.

Nëse trashëgimlënësi ka pasuri bashkëshortore të përfituara përgjatë martesës, nga data 28/01/1998 date e lidhjes se martesës dhe deri ne daten 27/11/2020 data e çeljes se trashëgimisë por të regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, vetëm në emrin e tij, regjistrimi i pjesës takuese të trashëgimisë ligjore do të bëhet duke zbritur 1/2 pjesë të prezumuar të bashkëshortit pasjetues, në referim me nenin 76 të Kodit Civil, nenit 112, pika e ligjit 110/2018 “Për Noterinë”.

Gjithashtu nëse trashëgimlënësi është i prezumuar bashkëpronar në ndonjë nga pasuritë e regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, atëherë, pjesa e prezumuar e bashkëpronësisë së tij do të kalojë tek trashëgimtarët ligjorë sipas pjesëve takuese. Bashkëlidhur Çertifikata e martesës Nr. akti nga Akti i martesës 1998) referuar nenit 112, pika 3 e ligjit 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

7. Bazuar ne parashikimet e nenit 113 dhe nenit 115 te Ligjit 110/2018 “Për noterinë” unë noteri procedova me lëshimin e një dëshmie të re trashëgimie, të cilën do jua njoftoj menjëherë të gjithë personave, të cilëve, sipas nenit 113, të këtij ligji, u është lëshuar një kopje origjinale e dëshmisë fillestare të trashëgimisë. Nr. Rep. 1553 Nr Kol 302 dt 21/12/2020
8. Me regjistrimin e këtij vendimi për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së Trashegimlënesit Gezim Kapaj, unë Noteri, bëj shënimin përkatës në dëshminë fillestare të trashëgimisë dhe e regjistroj atë në Regjistrin Kombëtar të Dëshmimeve të Trashëgimisë.
9. Kjo dëshmi trashëgimie ligjore u redaktua në 5 (pese) kopje origjinale më të njëjtën vlerë midis tyre, nga të cilat një kopje për secilin person që ju është lëshuar një kopje e dëshmisë fillestare të trashëgimie, një për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, institucion përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, dhe një kopje do të ruhet në arkivën noteriale.
10. Unë noteri informova kërkuesin për detyrimin ligjor të regjistrimit të kësaj dëshmie trashëgimie ligjore, pranë Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës kompetente kudo ku ndodhen pronat brenda 30 (tridhjet) ditësh duke filluar nga data e sotme, me qëllim kalimin e të drejtave dhe detyrimeve nga trashëgimlënësi tek trashëgimtarit ligjor, në rast të kundërt, për çdo ditë vonesë, aplikohen penalitetet përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi, referuar nenit 25, pika 2 e ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”.
11. Shpenzimet noteriale i ngarkohen kërkuesit. Shpenzimet noteriale për redaktimin e këtij akti noterial “Dëshmi Trashëgimie ligjore” përbëhen nga 10.000 Lek Tarifë Shërbimi + 200 Lek Pullë Tarife, e cila i aplikohet kopjes së aktit që ruhet në arkivën noteriale.



A2031042560003215193

12. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri/ja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj dëshmie, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme

13. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatë sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

U lëshua sot në Tiranë, më datë 08/02/2021 (dymijë e njëzet e një)

NOTER

HELENA B. SHËNGJERGJI (VAKO)

Helena Shëngjergji, vak,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER HELENA B. SHËNGJERGJI
(VAKO)
ADRESA NR.10, BLV"GJERGJ
FISHTA", NR.6, NR.8, NR.3
TEL: 682080755

DEKLARATË NOTERIALE

(DEKLARATË ME PËRMBAJTJE TË TJERA)

Nr. repertori: 141

Nr. koleksioni: 22

Tirane më 01/02/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021052860002572782



DEKLARATË NOTERIALE

(PËR HEQJEN DORË NGA TRASHËGIMIA)

Sot, më datë 01/02/2021 ora 04:08 pasdreke, para meje Notere HELENA B. SHËNGJERGJI(VAKO), anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, NR.10, BLV"GJERGJ FISHTA", NR.6, NR.8, NR.3, u paraqit personalisht:

DEKLARUES/IT:

Rudina Kapaj, atësia Faruk, amësia Fatbardha, shtetase Shqiptare, lindur në Berat dhe banuese në TIRANË, me adresë Andon Zako Çajupi; Nd. 20; H. 4; Ap. 11; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 14/01/1972, gjendja civile "e ve", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035463720 dhe nr. personal H25114087U, e cila nën përgjegjësinë e saj personale dhe në vullnet të lirë e të plotë, më deklaruan heqjen dore nga trashëgimia si më poshtë vijon:

Une Rudina Kapaj duke qene se jam brenda afatit ligjor 3 (tre) mujor per heqjen dore nga trashëgimia duke qene e vetedijshme per parashikimet ligjore per heqjen dore nga trashëgimia dhe pasojat ligjore te saj, bazuar ne nenin 333 te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, deklaroj me vullnet te lire dhe te plote se:

- heq dore plotesisht nga trashëgimia e lene nga bashkeshorti im Gezim Kapaj, i cili ka nderuar jete me 27/11/2020
- se nuk kam hequr apo fshehur sende nga trashëgimia,
- nuk jam sjelle si trashëgimtare
- nuk kam femije te mitur, nuk kam femije te lindur jashte martese dhe as persona te paafte dhe ne ngarkim tim qe vijne ne trashëgim me zevendesim ne trashëgimi.
- Jam i vetedijshme se heqja dore nga ana ime nga trashëgimia, ka fuqi nga ky moment dhe nuk mund te shfuqizohet ne asnje moment nga ana ime.

Deklarueses ju shpjegua nga une noteri dispozita e nenit 339 e Kodit Civil për mosshfuqizimin e kësaj deklarate pas momentit të heqjes dorë nga trashëgimia dhe deklaroi se ky eshte vullneti i lire dhe i plote i saj, dhe se eshte ne dijeni te dispozites ligjore per mosshfuqizimin e kesaj deklarate si dhe konfirmohet ne permbajtjen e kesaj deklarate.

Deklarata e mësipërme, u hartua në gjuhën shqipe dhe u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të deklaruesit/ses të mësipërme. Pasi ai/ajo deklaroi se u njoh dhe i kuptoi efektet juridike të aktit, dhe pasojat juridike te ketij deklarimi e nënshkruan atë rregullisht përpara meje Noterit.

Kjo deklaratë, u hartua nga unë Noteri në 5 (pese) kopje origjinale, me vlera të njëjta juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të deklarueses. Shpenzimet noteriale per redaktimin e kesaj deklarate perbehen nga 2.000 lek Tarife Sherbimi + 200 Pulle Tarife e cila i aplikohet kopjes e aktit qe ruhet ne arkiven noteriale.

Unë Noterja, verifikova identitetin e tij/saj nëpërmjet dokumenteve të identitetit cituar më sipër dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin nenit 62, pika 1, germa "II", të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoi nënshkrimin e deklaruesit/ses. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të kësaj deklarate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

DEKLARUES/IT

Rudina Kapaj

Rudina Kapaj

NOTER

HELENA B. SHËNGJERGJI(VAKO)

Helena Shëngjergji Vako

Fq. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER HELENA B. SHËNGJERGJI
(VAKO)
ADRESA NR.10, BLV" GJERGJ
FISHTA", NR.6, NR.8, NR.3
TEL: 682080755

DEKLARATË NOTERIALE

(DEKLARATË ME PËRMBAJTJE TË TJERA)

Nr. repertori: 142

Nr. koleksioni: 23

Tirane më 01/02/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021052860002665159



DEKLARATË NOTËRIALE

(PËR HEQJEN DORË NGA TRASHËGIMIA)

Sot, më datë 01/02/2021, ora 04:26 pasdreke para meje Notere HELENA B. SHËNGJERGJI(VAKO), anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.10, BLV"GJERGJ FISHTA", NR.6, NR.8, NR.3, u paraqit personalisht:

DEKLARUES/IT:

Geri Kapaj, atësia Gëzim, amësia Rudina, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në TIRANË, me adresë Andon Zako Çajupi; Nd. 20; H. 4; Ap. 11; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 07/05/1999, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036022484 dhe nr. personal J955070400, e cila nën përgjegjësinë e saj personale dhe në vullnet të lirë e të plotë, më deklaruan heqjen dore nga trashëgimia si më poshtë vijon:

Une Geri Kapaj duke qene se jam brenda afatit ligjor 3 (tre) mujor per heqjen dore nga trashëgimia duke qene e vetedijshme per parashikimet ligjore per heqjen dore nga trashëgimia dhe pasojat ligjore te saj, bazuar ne nenin 333 te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, deklaroj me vullnet te lire dhe te plote se:

- heq dore plotesisht nga trashëgimia e lene nga babai im Gezim Kapaj, i cili ka nderuar jete me 27/11/2020
- se nuk kam hequr apo fshehur sende nga trashëgimia
- nuk jam sjelle si trashëgimtare
- nuk kam femije te mitur, nuk kam femije te lindur jashte martese dhe as persona te paafte dhe ne ngarkim tim qe vijne ne trashëgim me zevendesim ne trashëgimi.
- Jam i vetedijshme se heqja dore nga ana ime nga trashëgimia, ka fuqi nga ky moment dhe nuk mund te shfuqizohet ne asnje moment nga ana ime.

Deklarueses ju shpjegua nga une noteri dispozita e nenit 339 e Kodit Civil për mosshfuqizimin e kësaj deklarate pas momentit të heqjes dorë nga trashëgimia dhe deklaroi se ky eshte vullneti i lire dhe i plote i saj, dhe se eshte ne dijeni te dispozites ligjore per mosshfuqizimin e kesaj deklarate si dhe konfirmohet ne permbajtjen e kesaj deklarate.

Deklarata e mësipërme, u hartua në gjubën shqipe dhe u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të deklaruesit/ses të mësipërme. Pasi ai/ajo deklaroi se u njoh dhe i kuptoi efektet juridike të aktit, dhe pasojat juridike te ketij deklarimi e nënshkruan atë rregullisht përpara meje Noterit. Kjo deklaratë, u hartua nga unë Noteri në 5 (pese) kopje origjinale, me vlera të njëjta juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të deklarueses. Shpenzimet noteriale per redaktimin e kesaj deklarate perbehen nga 2.000 lek Tarife Sherbimi + 200 Pulle Tarife e cila i aplikohet kopjes e aktit qe ruhet ne arkiven noteriale.

Unë Noterja, verifikova identitetin e tij/saj nëpërmjet dokumenteve të identitetit cituar më sipër dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin nenit 62, pika 1, germa "II", të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoi nënshkrimin e deklaruesit/ses. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroi se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të kësaj deklarate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

DEKLARUES/IT

NOTER

Geri Kapaj

HELENA B. SHËNGJERGJI(VAKO)

Geri Kapaj

[Signature]

[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË



NOTER HELENA B. SHËNGJERGJI
(VAKO)
ADRESA NR.10, BLV "GJERGJ
FISHTA", NR.6, NR.8, NR.3
TEL: 682080755

VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 1553

Nr. koleksioni: 302

Tirane më 21/12/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/01/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"

* Në materialin elektronik nga 8 fletë



A2020052860031773020



A302005286003177320

LËSHIMI I DËSHMISË SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Sot në datën 21/12/2020, (dymijë e njetzet) unë Helena Shëngjergji (Vako) noter i Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë me zyrë në Blvd "Gjergj Fishta" Nd. 6, H.3, ap. 8, mora në shqyrtim kërkesën dhe dokumentacionin e

KËRKUESE:

Zj. Rudina Kapaj, e bija e Faruk dhe Fatbardha, e datëlindjes 14/01/1972 lindur në Berat, banuese në Tiranë, Rr. "Andon Zako Çajupi, nd. 20, H. 4, Ap 11, Njesia Administrative Nr. 5, Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019 Tirana, me gjendje civile "e ve", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepuar, identifikuar nga letërnjoftimi me numër personal identiteti H25114087U

OBJEKTI I KËRKESËS: Lëshimi i dëshmisë të trashëgimisë ligjore për sistemimin e të drejtave dhe detyrimeve të të ndjerit z. GEZIM KAPAJ, i cili ka ndërruar jetë më 27/11/2020, me vendbanim të fundit në Tiranë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 316, 317, 318, 348, 360, 361 e vijues i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë", me ndryshimet, neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë

Kërkesja zj. Rudina Kapaj ka kërkuar lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë të të ndjerit Gezim Kapaj. Së pari unë noter i kontrollova kompetencën lëndore dhe kompetencën vendore.

Duke parë natyrën e kërkesës vërej se ekziston kompetenca lëndore dhe si e tillë kjo kërkesë mund të trajtohet prej meje noterit. Kështu, neni 348 i K.Civil parashikon se: "Cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese në trashëgimi caktohen në dëshminë e trashëgimisë, të lëshuar nga noteri, pas paraqitjes së çertifikatës së vdekjes së trashëgimtarit, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod dhe në ligjin për noterinë." Neni 112 i ligjit 110/2018 "Për Noterinë", parashikon se:

"Dëshmia e trashëgimisë lëshohet nga noteri, në përputhje me rregullat e caktuara në Kodin Civil, si dhe në këtë ligj."

Përsa i përket kompetencës vendore, duke qënë se vendbanimi i fundit i të ndjerit, bazuar në Çertifikatën e Vdekjes ka qënë në Tiranë, atëherë bazuar në paragrafin e dytë të nenit 348 të K.Civil, i cili parashikon se: "Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet nga noteri i njësise vendore ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimtarit.", unë si noter i njësise vendore Tiranë kam kompetencë vendore.

Përsa i përket legjitimitetit të kërkueses, duke qënë se sic provohet nga Çertifikata Familjare është në lidhje gjinie të afërt me të ndjerin, më konkretisht bashkeshortja e tij, në bazë të nenit 360 të Kodit Civil i cili parashikon se: "Trashëgimtarët ligjorë janë fëmijët, fëmijet e fëmijëve, bashkeshortit, prindërit, vëllezërit e motrat dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur, gjyshi e gjyshja e të paralinçurit e tjerë, personat e paaftë për punë në ngurkim të trashëgimtarit, të afërmit e tjerë deri në shkallën e gjashtë, si dhe shteti. Këta thirren në trashëgim sipas rradhës të caktuar në këtë Kod.", ajo hyn në rradhën e trashëgimtarëve ligjorë



të radhës së parë të të ndjerit dhe për rrjedhojë ka interes të ligjshëm në kërkinin e lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë.

Duke qënë se pas verifikimit nëse i ndjeri ka lënë testament, apo nese eshte leshuar deshmia nga noter tjetër, nga përgjigja e DHKN, administruar në dosje, më lëndë "Kthim përgjigje kërkesës me Nr 1344-4, rezulton se e ndjeri nuk ka lënë testament dhe nuk është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore nga ndonje noter tjetër, bazuar në ligjin 110/2018: "Për Noterinë" unë noteri mund të procedoj me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë të z. Gezim Kapaj. Përsa i përket themelit të kërkesës, pasi shqyrtova dokumentacionin e dosjes, shpjegimet e kërkueses, Çertifikatën e vdekjes, Çertifikatat e martesës, Çertifikatën familjare, Çertifikatën personale të trashëgimtares.

VËREJ SE:

Nga kërkuësja, është kërkuar "Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore" për trashëgimlënësin të ndjerin **GEZIM KAPAJ**, mashkull, i biri i Tetem dhe Fatime, i datelindjes 22/05/1959 lindur ne Hekal Fier, shtetas shqiptar, me numer personal identiteti F90522047Q, me gjendje civile i martuar, i cili ka ndërruar jetë më 27/11/2020, me vendbanim te fundit në Tiranë. Ky fakt provohet nga Çertifikatë Vdekje, lëshuar ne baze te aktit te vdekjes dt 07/12/2020, nga Bashkia Tirane, Njësia Administrative Tirane Nr. 5 377, Zyra e Gjendjes Civile 377 Njesia Administrative Nr. 5.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur të administruar në dosje dhe shpjegimet e kërkueses rezulton se; Sipas Çertifikates se Marteses, (nga Akti i marteses viti 1998) lëshuar në datën 10/12/2020 nga Qarku Tirane, Rrethi Tirane, Zyra e Gjendjes Civile (Arkiva) Bashkia Tirane, i ndjeri Gezim Kapaj, ka lidhur martese me Rudina Halitaj, e bija e Faruk dhe Fatbardha, e datelindjes 14/01/1972, mbiemri pas martese Kapaj.

Sipas Çertifikatës së Përberjes Familjare, dt 09/12/2020 lëshuar nga Bashkia Tirane Njesia Administrative Nr. 5 377, Zyra e Gjendjes Civile 377, në bazë të regjistrit kombetar te gjendjes civile te vitit 2010, rezulton se në përbërjen familjare të familjes të z. Gezim Kapaj, te cilet vijne ne trashegimi jane:

- Rudina Kapaj, femer e bija e Faruk dhe Fatbardha, e datelindjes 14/01/1972
- Dario Kapaj, mashkull, i biri i Gezim dhe Rudina, i datelindjes 19/06/1997
- Geri Kapaj, femer, e bija e Gezim dhe Rudina, e datelindjes 07/05/1999

Kërkuësja me vullnetin e saj të lirë dhe e vetëdijshme për pasojat ligjore në rast të deklarimit të ramë deklaroi se; në cilësinë e trashëgimtares ligjore nuk ka ndonjë pengesë ligjore për të trashëguar; nuk ka trashëgimtarë të tjerë ligjorë të radhës së parë brenda apo jashtë martesë apo fëmijë të tjerë të birësuar, nuk ka ndonjë akt i cili të ketë shpallur padenjësinë për ta trashëguar; nuk jemi përpara ndonjë rasti të heqjes dorë nga trashëgimia;

Sa më sipër shpjegohen nga dokumentacioni i paraqitur bashkëngjitur ketij akti.

Pasi u renditën faktet e mësipërme, në bazë të nenove 318, 318/1 dhe 318/2 të Kodit Civil të ndryshuar, në rastin konkret koha kur çelët trashëgimia është data e vdekjes së trashëgimlënësit z. Gezim Kapaj, dhe pikërisht data 27/11/2020, vendi i çeljes së trashëgimisë është në Tiranë, vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit. Ligji që do të aplikohet për çeljen e trashëgimisë është Kodi Civil në fuqi në datën 27/11/2020



Në bazë të nenit 317 të Kodit Civil të sipërpërmendur trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament. Në rastin konkret rezultoi se nuk është lënë testament. Duke qënë se nuk rezultoi të jetë lënë testament, për të lëshuar dëshminë e trashëgimisë, do të zbatohen dispozitat ligjore të Kodit Civil që rregullojnë trashëgiminë ligjore.

Në bazë të Kodit Civil në fuqi në datën 27/11/2020 që një person të mund të jetë trashëgimtar ligjor do duhet të plotësojë në mënyrë kumulative një sërë kushtesh si:

- -së pari të ketë zotësi për të trashëguar,
- -së dyti të bëjë pjesë në radhën e trashëgimtarëve ligjorë,
- -së treti të mos jetë shpallur i padenjë për të trashëguar, ose të mos jetë përjashtuar nga trashëgimi, ose të mos ketë hequr dorë nga trashëgimi sic përcaktohen nga ligji.

Përsa i përket kushtit të parë, zotësi për të trashëguar në bazë të nenit 320 të K.C, *“Ka personi që në kohën e çeljes së trashëgimisë, është gjallë,.....”*

Përsa i përket kushtit të dytë, neni 360 i K.C parashikon se: *“Trashëgimtarë ligjorë janë fëmijet, fëmijet e fëmijeve bashkëshorti, prindërit ,..... Këta thirren në trashëgimi sipas radhës së përcaktuar në këtë Kod.”*

Përsa i përket kushtit të tretë, neni 361/1/2 i Kodit Civil i cili parashikon se *“Në radhë të parë thirren në trashëgim fëmijet dhe bashkëshorti i aftë apo i paafte për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta. Kur një nga fëmijet ka vdekur para trashëgimlënësit, është bërë i padenjë për të trashëguar, ka hequr dorë nga trashëgimi, ose është i përjashtuar nga trashëgimi, në vend të tij hyjnë me zëvendësim fëmijet e tij dhe kur për shkaqet e sipërme nuk mund të jenë trashëgimtarë, vijnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kusfizim. Në këtë rast, pjesa e prindit që nuk trashëgon, ndahet ndërmjet të paslindurve në pjesë të barabarta.”*

Nga interpretimi i dispozitave të mësipërme ligjore rezulton se kur çelet trashëgimia ligjore në radhë të parë përfitojnë bashkëshortja dhe fëmijet e trashëgimlënësit në pjesë të barabarta, të cilët janë gjallë në çastin e çeljes së trashëgimisë, nuk kanë hequr dorë nga trashëgimia apo të jenë shpallur të padenjë apo të jenë përjashtuar nga trashëgimia.

Nisur nga rrethanat e faktit siç rezultuan nga dokumentacioni i administruar në dosje dhe shpjegimet e kërkueses në rastin konkret rezulton se;

- bashkëshortja e trashëgimlënësit Rudina Kapaj dhe dy fëmijet Dario Kapaj dhe Geri Kapaj kane qënë gjallë në datën e çeljes së trashëgimisë, bëjnë pjesë në radhën e trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë, nuk jane shpallur te padenjë për të trashëguar, nuk kane hequr dorë nga trashëgimia, nuk jane përjashtuar nga e drejta per ta trashëguar, për rrjedhojë ata kane zotësi juridike për ta trashëguar, dhe trashëgojne të gjithë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të tij ne pjesë takuese ideale të barabarta

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 316, 317, 318, 318/1, 318/2 , 320, 330, 348, 360, 361, të Kodit Civil, tëndryshuar me ligjin Nr. 121/2013, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 7850 dt 29.07.1997 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” Neni 388 i Kodit të Procedurës Civile; Ligjit 110/2018 “Për Noterinë”



1. Pranimin e kërkesës së kërkuësës
2. Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin të ndjerin z. **GEZIM KAPAJ**, mashkull, i biri i Tetem dhe Fatime, i datelindjes 22/05/1959, lindur ne Hekal Fier, shtetas shqiptar, me gjendje civile "i martuar", me numer personal identiteti F90522047Q, me vendbanim te fundit ne Tirane, e cila celet ne datun e vdekjes me 27/11/2020.

3. Njohjen si trashëgimtare ligjore te radhes se pare te trashëgimlënësit;

- **Rudina Kapaj**, femër e bija e Faruk dhe Fatbardha, e datelindjes 14/01/1972, lindur ne Berat, me gjendje civile e ve, shtetase shqiptare, me numer personal identiteti H25114087U (bashkëshortja e trashëgimlënësit) 1/3 (një të tretën pjesë);
- **Dario Kapaj**, mashkull, i biri i Gezim dhe Rudina, i datelindjes 19/06/1997, lindur ne Athine Greqi, me gjendje civile beqar, shtetas shqiptar, me numer personal identiteti J70619059G, (i biri i trashëgimlënësit) 1/3 (një të tretën pjesë);
- **Geri Kapaj**, femër, e bija e Gezim dhe Rudina, e datelindjes 07/05/1999, lindur ne Tirane, me gjendje civile beqare, shtetase shqiptare, me numer personal identiteti J955070400, (e bija e trashëgimlënësit) 1/3 (një të tretën pjesë).

te cilet trashëgojne secili 1/3 pjese ideale te te gjithë pasurise trashëgimore te luajtshme dhe te paluajtshme dhe te drejtat mbi to

4. Në këto raporte kalojnë dhe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo trashëgimi.

5. Dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, nuk mund të çenojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës.

Nëse trashëgimlënësi ka pasuri bashkëshortore të përfituara përgjatë martesës, por të regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, vetëm në emrin e tij, regjistrimi i pjesës takuese të trashëgimisë ligjore do të bëhet duke zbritur 1/2 pjesë të prezumuar të bashkëshortit pasjetues, në referim me nenin 76 të Kodit Civil, nenit 112, pika e ligjit 110/2018 "Për Notarinë". Gjithashtu nëse trashëgimlënësi është i prezumuar bashkëpronar në ndonjë nga pasuritë e regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, atëherë, pjesa e prezumuar e bashkëpronësisë së tij do të kalojë tek trashëgimtarët ligjorë sipas pjesëve takuese. Bashkëlidhur Çertifikata e martesës Nr. akti nga Akti i martesës 1998) referuar nenit 112, pika 3 e ligjit 110, datë 20.12.2018 "Për Notarinë".

6. Kjo dëshmi trashëgimie ligjore u redaktua në 5 (pesë) kopje origjinale më të njëjtën vlerë midis tyre, nga të cilat një për secilin trashëgimtar, një për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, institucion përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, dhe një kopje do të ruhet në arkivën noteriale.

7. Unë noteri informova kërkuësen për detyrimin ligjor të regjistrimit të kësaj dëshmie trashëgimie ligjore, pranë Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës kompetente kudo ku ndodhen pronat brenda 30 (tridhjet) ditësh duke filluar nga data e sotme, me qëllim kalimin e të drejtave dhe detyrimeve nga trashëgimlënësi tek trashëgimtarët ligjore te tij, në rast të kundërt, për çdo ditë vonesë, aplikohen penalitetet përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi, referuar nenit 25, pika 2 e ligjit 111/2018 "Për Kadastrën".



8. Shpenzimet noteriale i ngarkohen kërkueses. Shpenzimet noteriale për redaktimin e këtij akti noterial "Dëshmi Tashëgimie ligjore" përbëhen nga 10.000 Lek Tarife Shërbimi + 2.000 Lek TVSH + 200 Lek Pultë Tarife, e cila i aplikohet kopjes së aktit që ruhet në arkivën noteriale.

8. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri/ja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kesaj dëshmie, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme

9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatë sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

U lëshua sot në Tiranë, më datë 21/12/2020 (dymijëdhjetë)

NOTER

HELENA B. SHËNGJERGJI (VAKO)

Helena Shëngjergji, Vako

[Handwritten signature]

